

VENDIM
Nr. 154, datë 13.3.2023

**PËR SHPALLJEN E HABITATIT TË TULIPANIT SHQIPTAR “MONUMENT
NATYROR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 10, të ligjit nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e habitatit të tulipanit shqiptar (*Tulipa albanica*) “Monument natyror”, kategoria III e zonave të mbrojtura, sipas hartës në shtojcën 1, dhe kufirit të paraqitur sipas tabelës së koordinatave në shtojcën 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Monumenti i natyrës ka një sipërfaqe 35.5 ha dhe zonë buferike 200 m rreth kufirit të zonës të mbrojtur, në të cilin zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes e njëjtë me rezervën strikte.

3. Zona e mbrojtur përfshin habitatin e një lloji të rrallë e të kërcënuar me rëndësi e vlerë të veçantë shkencore dhe estetike, sipas aneksit nr. 1, i cili përmban skedën e monumentit të natyrës.


4. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe organet përkatëse të vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Shtojca nr. 1

Harta e vendndodhjes së habitatit të Tulipanit shqiptar (*Tulipa albanica*), Surroj.



Shtojca nr. 2

Lista me koordinatat (ETRS 89 ALBNAIA 2010 e vendndodhjes së habitatit të Tulipanit shqiptar (*Tulipa albanica*), Surroj.

KOORDINATA E PIKAVE		
SISTEMI ETRS 89 ALBANIA 2010		
Nr	X	Y
1	527189	4656500
2	527316	4656484
3	527340	4656486
4	527442	4656451
5	527481	4656446
6	527542	4656449
7	527619	4656439
8	527683	4656437
9	527700	4656443
10	527741	4656447
11	527778	4656459
12	527878	4656464
13	527931	4656484
14	527980	4656455
15	527960	4656562
16	527966	4656632
17	527961	4656767
18	527927	4656832
19	527873	4656831
20	527843	4656861
21	527802	4656861
22	527706	4656892
23	527593	4656914
24	527503	4656926
25	527459	4656940
26	527404	4656948
27	527337	4656950
28	527320	4656951
29	527250	4656933
30	527202	4656942
31	527134	4656925
32	527153	4656756
33	527163	4656717
Sip=35.5 ha		

Aneksi nr. 1

**HABITATI I TULIPANIT SHQIPTAR (*Tulipa albanica*)
Monument Natyror (III)**

1. Taksonomia Mbretëria: Plantea Ndarja: Tracheophyta Klasa: Liliopsida Rendi: Liliales Familja: Liliaceae Gjinia: Tulipa	2. Rajoni biogeografik ALPINE	3. Vendndodhja lokale Bashkia: Kukës Njs. Adm: Surroj Fashti: Fushare	4. Koordinatat e qendrës (KRRGJSH 2010) X 527507 Y 4656729 Lartësia mnd 550-750m *Koordinatat e plota bashkëlidhur shtojcës	5. Sipërfaqja (ha) Sipërfaqja 35.5 ha Zona buferike: 200 m rreth kufirit të zonës qëndrore.
--	---	---	--	--

6. Habitat Pyje të temperuar 41.26 <i>Galio-Carpinetum</i> oak-hornbeam forests (Habitat Directive) 6.1 Përshkrimi i habitatit Kryesisht në celtira mes pyjeve të <i>Quercus</i> spp, <i>Forsythia europae</i> , <i>Juniperus oxycedrus</i> të dominuara nga <i>Polygalo-Forsythietum europaeae</i> dhe shoqërimet e aleancës <i>Quercus-Carpinion orientalis</i> . Takohet në terren të pjerrët, shkëmbinj gëlqeror, në substratin serpentinor, në lartësi 550-750m mbi rrafshin e detit. Tokat janë të kafajta acide. Kundrejtimi i sipërfaqes është nga lindja. Cilësia e habitatit po bie me humbjen e lëndëve ushqyese për shkak të mbulesës së ulët të bimësisë dhe përbërjes së substratit.	7. Bashkëshoqërimet bimore <i>Polygalo-Forsythietum europaeae</i> Shoqërimet te aleancës <i>Quercus-Carpinion orientalis</i> . Tulipani në habitatin e tij shoqërohet me llojet: <i>Aristolochia merxmulleri</i> , <i>Halacsya sendtneri</i> , <i>Paramoltkia doerfleri</i> , <i>Polygala doerfleri</i> , <i>Sanguisorba albanica</i> , <i>Veronica andrasovszkyi</i> , <i>Aster albanicus</i> subsp. <i>albanicus</i> dhe specie relikte terciare të <i>Euphorbia glabriflora</i> , <i>Genista hassertiana</i> dhe <i>Dioscorea balcanica</i> .	8. Përdorimi i territorit (mbulesa) -Pyll, forma e qeverisjes Shkurre dominuar nga Bushi (<i>Buxus sempervirens</i>) si dhe . Dëllinjë e kuqe dhe e zezë, Frashër, Shkozë, Trëndafil të egër, shoqëruar me bimësi barishtore (Graminace, Bishtajore, etj).
---	--	---

9. Përcaktimi i kërcënimeve Minierat, Zjarri, Kullotja e bagëtive, Grumbullimi i bimëve mjekësore, i barrit dhe i vet tulipanit për tregti dhe zbukurim, hedhja e inerteve, mbetjeve urbane.	10. Statusi i kërcënimit të llojit Në rrezik kritik (CR); popullatat në rënie.	11. Statusi i ruajtjes kombëtar/ndërkombëtar (i pa listuar)	12. Objektivi kryesor i menaxhimit Ruajtja/e habitateve të Tulipa albanica, si lloj endemic, në rrezik kritik, si dhe frenimi i përdorimit të tokës për qëllime të tjera.
--	--	---	---

13. Masat kryesore për konservim Shpallja zonë e mbrojtur e habitatit me qëllim ndalimin e përdorimit të sipërfaqes për miniera, ndalimin e kullotjes së çfarëdolloj të bagëtive, ndalimin e hedhjes së inerteve dhe të mbetjeve urbane. Dhënia e statusit të mbrojtjes në nivel kombëtar e ndërkombëtar. Hartimi i planit të veprimit për mbrojtjen e llojit. Ndalimin e marrjes së individëve për qëllime tregtimi apo mbjelljes në kopshte për zbukurim. Monitorimin e rregullt të gjendjes së habitatit në periudhën e lulëzimit. Rritja e prezencës së kontrollit në periudhën e lulëzimit kryesisht kur lloji bëhet i dukshëm në sipërfaqe. Marrja e masave kundër zjarrit.	14. Administrata përgjegjëse AdZM, qarku Kukës
---	--